

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË "Innoval Studio" SH.P.K.

Sot, me datë 11.12.2024

**Z. Kristi Mara**, shtetas Shqiptar, lindur 06.02.1995 më në Tirane Shqiperi, mbajtës i Kartes se ID me nr.me 037291264 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**Z. Nino Imeraj**, shtetas Shqiptar, lindur 04.04.1991 më në Tirane Shqiperi, mbajtës i Kartes se ID me nr.me 033964708 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Innoval Studio**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1

##### EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Innoval Studio**" Sh.p.k.

#### NENI 2

##### SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Kosovarëve, Pallati Dolcka, Hyrja 2.Shk 2.Ap 1, TIRANË. Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### NENI 3

##### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### NENI 4

##### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Krijimi dhe menaxhimi i faqeve të internetit, Ofrimi i domain-eve dhe shërbimeve të hosting-ut, Menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve sociale dhe marketingu online, Mirëmbajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve të komunikimit, Projektim dhe implementim i projekteve IT, Zhvillimi i softuerëve, platformave dixhitale dhe e-commerce, Ofrimi i shërbimeve të ndryshme informatike, Shërbime përkthimi dhe të tjera, Konsulencë për aplikimin e teknologjisë së informacionit, Importi dhe shitja e hardware-it.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 300,000 Lek dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

**Z. Nino Imeraj zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 150,000 Lek dhe 150,000 Lek të kapitalit themeltar.**

**Z. Kristi Mara zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 150,000 Lek dhe 150,000 Lek të kapitalit themeltar.**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi administrativ i shoqërisë janë Administratorët, **Z. Nino Imeraj dhe Z. Kristi Mara** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë

**NENI 8**

**DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Kristi Mara**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 037291264, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Kristi Mara**

Kristi Mara  


**Z. Nino Imeraj**

Nino Imeraj  
